



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra Ushtarake, duke i'u referuar Listës së Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të drejtave të njeriut.
2. Kjo listë është konform Listës së Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli i BE-së 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake dhe që zëvendëson Listën e Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli më 20 shkurt 2023/CFSP/2024.
3. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Institucionet tjera kompetente për zbatim të këtij vendimi.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e Përbashkët Ushtarake e Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli më datë 19 shkurt 2024, Nr. 5654/24 COARM 25 CFSP/PESC 105.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë